



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada – Government*

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 04/2023**  
**PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E VEÇANTA PËR DHËNIEN E LEJES PËR TË DËNUARIT QË**  
**TË PUNOJNË JASHTË INSTITUCIONIT KORREKTUES<sup>1</sup>**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MOJ-NO. 04/2023**  
**ON SPECIAL CONDITIONS AND PROCEDURES FOR GRANTING WORK PERMISSION FOR**  
**CONVICTS TO WORK OUTSIDE OF THE CORRECTIONAL INSTITUTION<sup>2</sup>**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MP-BR. 04/2023**  
**O USLOVIMA I POSEBNIM PROCEDURAMA ZA DAVANJE DOZVOLE ZA RAD OSUĐENICIMA**  
**VAN KOREKTIVNE INSTITUCIJE<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ Md-Nr. 04/2023 për Kushtet dhe Procedurat e Veçanta për Dhënien e Lejes për të Dënuarit që të Punojnë Jashtë Institucionit Korrektues, i nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, më datë 04.05.2023.

<sup>2</sup> Administrative Instruction Moj-No. 04/2023 On Special Conditions and Procedures for Granting Work Permission for Convicts to Work Outside of the Correctional Institution, signed by Minister of Justice, date 04.05.2023.

<sup>3</sup> Administrativno Uputstvo Mp-Br. 04/2023 O Uslovima I Posebnim Procedurama Za Davanje Dozvole Za Rad Osuđenicima Van Korektivne Institucije, je potpisano od strane Ministar Pravde, datum 04.05.2023.

<p><b>Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 71 (paragrafi 3) të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores QRK-Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren QRK-Nr. 04/2021 dhe Rregulloren QRK-Nr. 03/2022, si dhe në përputhje me nenin 38 (paragrafit 6) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 së Republikës së Kosovës,</p> <p>Nxjerrë:</p> <p style="text-align: center;"><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV MD - NR. 04/2023 PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E VEÇANTA PËR DHËNIEN E LEJES PËR TË DËNUARIT QË TË PUNOJNË JASHTË INSTITUCIONIT KORREKTUES</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ (në tekstin e mëtejshëm: Udhëzimi) është përcaktimi i kushteve dhe procedurave të veçanta për</p>	<p><b>Minister of the Ministry of Justice,</b></p> <p>In support of Article 71 (paragraph 3) of Law No. 08/L-132 on the Execution of Criminal Sanctions, based on Article 11 (paragraph 1, sub-paragraph 1.5) of Law No. 08/L-117 for the Government of the Republic of Kosovo and Article 8 (paragraph 1, sub-paragraph 1.4) of Regulation GRK-No. 02/2021 for the areas of administrative responsibility of the Prime Minister's Office and ministries, amended and supplemented by Regulation GRK-No. 04/2021 and Regulation GRK-No. 03/2022, as well as in accordance with Article 38 (paragraph 6) of the Rules and Procedure of Government No. 09/2011 of the Republic of Kosovo,</p> <p>Issue:</p> <p style="text-align: center;"><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MoJ - NO.04/2023 ON SPECIAL CONDITIONS AND PROCEDURES FOR GRANTING PERMISSION FOR CONVICTS TO WORK OUTSIDE OF THE CORRECTIONAL INSTITUTION</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>The purpose of this Administrative Instruction (here in after: Instruction) is to determine the special conditions and</p>	<p><b>Ministarka Ministarstva Pravde,</b></p> <p>U prilog članu 71 (stav 3) Zakona br. 08/L-132 o izvršenju krivičnih sankcija, na osnovu člana 11 (stav 1, podstav 1.5) Zakona br. 08/L-117 za Vladu Republike Kosovo i član 8 (stav 1, podstav 1.4) Uredbe KRK-br. 02/2021 za oblasti administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstava, izmenjen i dopunjen Uredbom KRK-br. 04/2021 i Uredbe qRK-br. 03/2022, kao i u skladu sa članom 38. stav 6. Uredbe o radu Vlade br. 09/2011 Republike Kosovo,</p> <p>Izdaje:</p> <p style="text-align: center;"><b>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MP-BR.04/2023 O USLOVIMA I POSEBNIM PROCEDURAMA ZA DAVANJE DOZVOLE ZA RAD OSUĐENICIMA VAN KOREKTIVNE INSTITUCIJE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1 Svrha</b></p> <p>Svrha ovog Administrativnog uputstva (na daljem tekstu: Uputstvo) je da utvrdi posebne uslove i procedure za davanje</p>
--	---	---

<p>dhënie e lejes për të dënuarit për punësim jashtë Institucionit Korrektues.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>Ky Udhëzim zbatohet ndaj të gjithë të dënuarve në Institucionin Korrektues të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë Udhëzim.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimi</b></p> <p>1. Për qëllim të këtij Udhëzimi shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim.</p> <p>1.1. <b>I dënuari</b> - nënkupton personin i cili është në ekzekutim të dënimit në Institucionin Korrektues;</p> <p>1.2. <b>I mitur</b> - nënkupton të miturin sipas përkufizimit në Kodin e Drejtësisë për të Mitur;</p> <p>1.3. <b>Punë</b> - nënkupton punë jashtë Institucionit Korrektues;</p> <p>1.4. <b>Punëdhënës</b> - nënkupton institucion, organizatë ose kompani publike apo private që ofron punë për personat e dënuar;</p>	<p>procedures for granting permission to convicts for employment outside the Correctional Institution.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p> <p>This Instruction applies to all convicts in the Correctional Institution who meet the conditions foreseen with this Instruction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 The definition</b></p> <p>1. For the purpose of this Instructions, the expressions used have this meaning.</p> <p>1.1. <b>The convict</b> - means the person who is serving the sentence in the Correctional Institution;</p> <p>1.2. <b>Minor</b> – means a minor as defined in the Juvenile Justice Code;</p> <p>1.3. <b>Work</b>- means work outside the Correctional Institution;</p> <p>1.4. <b>Employer</b> means-Institution, Organization or public or private company that offers job to convicted persons;</p>	<p>dozvole osuđenima za zapošljavanje van Korektivne institucije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2 Oblast delovanja</b></p> <p>Ovo uputstvo primenjuje se na sve osuđenike u Korektivnoj instituciji koji ispunjavaju uslove propisane ovim uputstvom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicija</b></p> <p>1. Za potrebe ovog uputstva, upotrebljeni izrazi imaju ovo značenje.</p> <p>1.1. <b>Osuđenik</b> - označava lice koje izdržava kaznu u Korektivnoj instituciji;</p> <p>1.2. <b>Maloletnik</b> – znači maloletnik kako je definisano u Zakonu o maloletničkom pravosuđu;</p> <p>1.3. <b>Rad</b> - podrazumeva rad van Korektivne institucije;</p> <p>1.4. <b>Poslodavac</b> je - javna ili privatna ustanova, organizacija ili kompanija koja nudi rad osuđenim licima;</p>
--	---	--

<p>1.5. <b>Marrëveshje</b> - nënkupton marrëveshjen mes punëdhënësit, Institucionit Korrektues dhe të dënuarit;</p> <p>1.6. <b>Kontrata</b> - nënkupton kontratën e lidhur mes punëdhënësit dhe personit të dënuar për punë jashtë Institucionit Korrektues;</p> <p>1.7. <b>Drejtor i Përgjithshëm</b> - nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Parimet për punën e personit të dënuar</b></p> <p>Personi i dënuar në llojin e punës së dhënë nuk mund të diskriminohet në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.</p>	<p>1.5. <b>Agreement means</b> - the agreement between the employer, the Correctional Institution and the convict;</p> <p>1.6. <b>Contract means</b> - the contract concluded between the employer and the convicted person, for work outside the Correctional Institution;</p> <p>1.7. <b>General Director</b> - means the General Director of the Kosovo Correctional Service.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Principles for the work of a convicted person</b></p> <p>The convicted person in the type of work given can not be discriminated on the basis of nationality or affiliation with any community, social or national origin, race, ethnicity, color, birth, origin, sex, gender, gender identity, sexual orientation, language, citizenship, religious belief, political affiliation, political opinion or other opinions, social or personal status, age, family or marital status, pregnancy, maternity, financial status, health status, disability, genetic inheritance or any other basis, in order to of the application of the principle of equal treatment.</p>	<p>1.5. <b>Sporazum</b> znači - sporazum između poslodavca, Korektivne institucije i osuđenog;</p> <p>1.6. <b>Ugovor</b> znači - ugovor zaključen između poslodavca i osuđenog lica, o radu van Korektivne institucije;</p> <p>1.7. <b>Generalni direktor</b> – znači generalni direktor Korektivne Službe Kosova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Načela za rad osuđenog lica</b></p> <p>Osuđeno lice u vrsti posla ne može biti diskriminisano na osnovu nacionalnosti ili pripadnosti bilo kojoj zajednici, društvenog ili nacionalnog porekla, rase, etničke pripadnosti, boje kože, rođenja, porekla, pola, rodnog identiteta, seksualne orijentacije, jezika, državljanstvo, versko uverenje, političko opredeljenje, političko mišljenje ili druga mišljenja, društveni ili lični status, godine, porodični ili bračni status, trudnoća, materinstvo, materijalno stanje, zdravstveno stanje, invaliditet, genetsko nasleđe ili bilo koji drugi osnov, kako bi se primena principa jednakog tretmana.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Qëllimi i punësimit</b></p> <p>1. Qëllimi i punësimit është që personi i dënuar të fitojë, të ruajë dhe zhvillojë aftësitë punuese, shprehitë e punës dhe njohuritë profesionale si dhe të ndikoj në riedukimin dhe risocializimin e tij për fillimin e sërishëm të jetës normale sa më parë që të jetë e mundur pas mbajtjes së dënimit.</p> <p>2. Institucioni Korrektues nëse është e mundur duhet të siguroj punë për personin e dënuar.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Purpose of employment</b></p> <p>1. The purpose of the employment is for the convicted person to acquire, maintain and develop work skills, work habits and professional knowledge, as well as to influence his reeducation and resocialization for starting a normal life again as soon as possible after serving the sentence.</p> <p>2. The Correctional Institution, if possible, must provide work for the convicted person.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Svrha zaposlenja</b></p> <p>1. Svrha zaposlenja je da osuđeno lice stekne, održi i razvije radne veštine, radne navike i stručna znanja, kao i da utiče na njegovo prevaspitanje i resocijalizaciju da što pre ponovo započne normalan život, moguće nakon izdržane kazne.</p> <p>2. Korektine institucija, ako je moguće, mora da obezbedi rad osuđenom licu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Kushtet për punësim jashtë Institucionit Korrektues</b></p> <p>1. Punësimi jashtë Institucionit Korrektues mund të lejohet vetëm për të dënuarit të cilët i plotësojnë kushtet si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. janë të vendosur në institucionet e tipit të hapur dhe gjysmë të hapur apo janë të vendosur në Njësi të hapur në institucione korrektuese të tipit të mbyllur;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. janë shfrytëzues të pushimit të rregullt jashtë Institucionit Korrektues;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. të jetë siguruar një vend pune, i cili është i ligjshëm për të punuar jashtë Institucionit Korrektues;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Conditions for employment outside the Correctional Institution</b></p> <p>1. Employment outside Correctional Institution can only be allowed for convicts who meet the following conditions:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. are placed in open and semi-open type institutions or are placed in open units in closed type correctional institutions;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. are users of regular leave outside the Correctional Institution;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. to have secured a job which is legal to work outside the Correctional Institution;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Uslovi za zapošljavanje van Korektivne Institucije</b></p> <p>1. Zapošljavanje van Korektivne institucije može biti dozvoljeno samo za osuđena lica koja ispunjavaju sledeće uslove:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Smešteni su u ustanove otvorenog i poluotvorenog tipa ili su smešteni u jedinice otvorenog tipa u korektivnim institucijama zatvorenog tipa;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Su korisnici redovnog odsustva van Korektivne institucije;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Da ima obezbeđen posao koji je legalan za rad van Korektivne institucije;</p>

<p>1.4. vendi i punës dhe personeli ku planifikohet të punoj i dënuari nuk duhet të kenë lidhje me veprën penale për të cilën është duke e mbajtur dënimin personi i dënuar;</p> <p>1.5. rekomandimi i panelit profesional për punë jashtë Institucionit;</p> <p>1.6. deklarimi me shkrim i të dënuarit se do t'iu përmbahet kushteve të përcaktuara me këtë Udhëzim dhe kushtetve të veçanta të caktuara nga autoriteti që jep leje për të punuar jashtë Institucionit Korrektues.</p> <p>2. Përjashtimisht nënparagrafit 1.2 të këtij neni, i dënuari i cili është dënuar për herë të parë me dënim me burg deri në gjashtë (6) muaj, i cili ka qenë i punësuar deri në kohën e ardhjes në burg, mund të lejohet të punoj jashtë Institucionit në vendin e tij të punës, nëse nuk parashihet ndryshe me ligj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Vendi i punës</b></p> <p>1. Vendi i punës për personat që i plotësojnë kushtet sipas këtij Udhëzimi mund të propozohet nga:</p>	<p>1.4. the place of work and the staff where the convicted person plans to work must not be related to the criminal offense for which the convicted person is serving his sentence;</p> <p>1.5. recommendation of the professional panel for work outside the Institution;</p> <p>1.6. the written declaration of the convict that he will comply with the conditions set forth with this Instruction and the special conditions set by the authority that grants permission to work outside the Correctional Institution.</p> <p>2. With the exception of sub paragraph 1.2 of this article, the convict who has been sentenced for the first time with a prison sentence of up to six (6) months, who was employed until the time of his arrival in prison, may be allowed to work abroad the institution at his place of work, unless otherwise provided by law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Work place</b></p> <p>1. The workplace for persons who meet the conditions according to these Instructions can be proposed by:</p>	<p>1.4. Mesto rada i osoblje u kojem osuđeni planira da radi ne smije biti u vezi sa krivičnim delom za koje osuđeni izdržava kaznu;</p> <p>1.5. Preporuka profesionalnog panela za rad van institucije;</p> <p>1.6. Pismenu izjavu osuđenog da će ispunjavati uslove utvrđene ovim uputstvom i posebne uslove koje utvrđuje organ koji daje dozvolu za rad van Korektivne institucije.</p> <p>2. Izuzev stava 1.2 ovog člana, osuđenom koji je prvi put osuđen na kaznu zatvora do šest (6) meseci, a koji je bio u radnom odnosu do dolaska u zatvor, može se dozvoliti da radi u van institucije na svom radnom mestu, osim ako zakonom nije drugačije određeno.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Radno mesto</b></p> <p>1. Radno mesto za lica koja ispunjavaju uslove iz ovog uputstva mogu predložiti:</p>
---	--	---

<p>1.1. Institucioni Korrektues sipas marrëveshjes me punëdhënësin ju siguron të dënuarve punë jashtë Institucionit.</p> <p>1.2. I dënuari mund të propozoj një vend pune për të punuar jashtë Institucioni Korrektues.</p> <p>2. Punëdhënësi mund t'i paraqes ofertë Institucionit Korrektues për punësimin e të dënuarve.</p> <p>3. Adresa e vendit të punës duhet të përcaktohet saktë, i dënuari mund të punoj vetëm në objektin e punëdhënësit dhe nuk lejohet puna në teren.</p>	<p>1.1. The Correctional Institution according to the agreement with the employer provides convicts with work outside the Institution.</p> <p>1.2. The convict can propose a workplace to work outside the Correctional Institution.</p> <p>2. The employer can submit offers to Correctional Institution for the employment of the convicts.</p> <p>3. The address of the place of work must be determined correctly, the convict can only work in the employer's facility and work in the field is not allowed.</p>	<p>1.1. Korektivna institucija prema ugovoru sa poslodavcem obezbeđuje osuđenicima rad van institucije.</p> <p>1.2. Osuđeni može predložiti radno mesto za rad van Institucioni Korrektues.</p> <p>2. Poslodavac može predstaviti Korektivnoj instituciji ponudu za zapošljavanje osuđenih lica.</p> <p>3. Adresa mesta rada mora biti tačno određena, osuđeni može da radi samo u objektu poslodavca i nije dozvoljen rad na terenu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Përzgjedhja e vendit të punës</b></p> <p>Personi i dënuar në pajtim me dispozitat e këtijë Udhëzimi bën përzgjedhjen e vendit të punës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Selection of the workplace</b></p> <p>The convicted person, in accordance with the provisions of this Instruction, makes the selection of the workplace.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Izbor radnog mesta</b></p> <p>Osuđeno lice, u skladu sa odredbama ovog uputstva, vrši izbor radnog mesta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Procedura për dhënien e lejes për të dënuarin për punësim jashtë Institucionit Korrektues</b></p> <p>1. I dënuari ka të drejtë të parashtrojë kërkesë Drejtorit të Institucionit Korrektues për punë jashtë Institucionit Korrektues sipas formës së</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Procedure for granting permission to the convict for employment outside the Correctional Institution</b></p> <p>1. The convict has the right to submit a request to the director of the Correctional Institution for work outside the Correctional</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Postupak za davanje odobrenja osuđenom za zapošljavanje van Korektivne Institucije</b></p> <p>1. Osuđeni ima pravo da podnese zahtev direktoru Korektivne institucije za rad van Korektivne institucije prema obrascu</p>

<p>kërkesës në <i>Shtojcën 1</i>, e cila është pjesë e këtij Udhëzimi.</p> <p>2. Krahas kërkesës duhet të paraqet edhe çertifikatën e regjistrimit të biznesit dhe çertifikatën e numrit fiskal.</p> <p>3. Nëse punëdhënësi dhe i denuari nuk ofrojnë dokumentacionin e kërkuar, Institucioni Korrektues mund të mos lidhë marrëveshje për punësimin e të dënuarit.</p> <p>4. Drejtori i Institucionit Korrektues pas pranimit të kërkesës, brenda afatit pesë (5) ditë pune rastin e kalon në Panelin profesional në Institucionit Korrektues për vlerësim.</p> <p>5. Paneli profesional themelohet me vendim të Drejtorit të Institucionit Korrektues në përbërje prej pesë (5) anëtarë.</p> <p>6. Paneli profesional brenda afatit të arsyeshëm, jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë pas pranimit të kërkesës për punë jashtë Institucionit Korrektues duhet ta shqyrtoj dhe vlerësoj kërkesën dhe të dal me rekomandim me shkrim.</p>	<p>Institution according to the request form in <i>Appendix 1</i>, which is part of this Instruction.</p> <p>2. In addition to the request, the business registration certificate and the fiscal number certificate must also be submitted.</p> <p>3. If the employer and the convict does not provide the required documentation, Correctional Institution may not conclude an agreement for the employment of the convicted person.</p> <p>4. After receiving the request, the Director of Correctional Institution passes the case to the Correctional Institution Professional Panel for evaluation within five (5) working days.</p> <p>5. Professional panel is established with the decision of the Correctional Institution director made of five (5) members.</p> <p>6. The professional panel within a reasonable period of time, no longer than thirty (30) days after receiving the request for work outside the Correctional Institution, must examine and evaluate the request and issue a written recommendation.</p>	<p>zahteva u <i>prilogu 1</i>, koji je deo ovog uputstva.</p> <p>2. Pored zahteva potrebno je dostaviti i potvrdu o registraciji preduzeća i potvrdu o fiskalnom broju.</p> <p>3. Ako poslodavac ne obezbedi traženu dokumentaciju, Korektivna institucija ne može zaključiti ugovor o zapošljavanju osuđenog lica.</p> <p>4. Nakon prijema zahteva, direktor Korektivne institucije prosleđuje predmet profesionalnom panelu Korektivne institucije na procenu u roku od pet (5) radnih dana.</p> <p>5. Profesionalni panel se osniva odlukom direktora IK, koje se sastoji od pet (5) članova.</p> <p>6. Stručno veće u razumnom roku, ne dužem od sedamdeset (30) dana od dana prijema zahteva za rad van Korektivne institucije, mora razmotriti i oceniti zahtev i dati pismenu preporuku.</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Rrethanat për dhënie të lejes për punë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Circumstances for granting a work permit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Okolnosti za izdavanje radne dozvole</b></p>
<p>1. Për dhënien e lejes për punë jashtë Institucionit Korrektues duhet të merren parasysh rrethanat si në vijim:</p> <p>1.1. plotësimi i kushteve të parapara me nenin 6 të këtij Udhëzimi;</p> <p>1.2. pajtueshmërinë me planin e dënimit dhe bashkëpunimin e të dënuarit në respektimin e planit të dënimit;</p> <p>1.3. sjelljen, personaliteti dhe gjendja shëndetësore e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit;</p> <p>1.4. gjendja sociale e familjes së të dënuarit;</p> <p>1.5. distanca, koha dhe mënyra e udhëtimit nga Institucioni Korrektues deri në vendin e punës dhe anasjelltas e cila nuk mund të jetë më e gjatë se tre (3) orë duke përfshirë të dy relacionet;</p> <p>1.6. personi i dënuar të mos ketë ndalim të ushtrimit të profesionit apo punës për të cilën kërkon leje për punë jashtë Institucionit Korrektues;</p>	<p>1. The following circumstances must be taken into account for granting a work permit outside the Correctional Institution:</p> <p>1.1. fulfillment of the conditions provided for in Article 6 of this Instruction;</p> <p>1.2. compliance with the sentencing plan and the cooperation of the convicted person in complying with the sentencing plan;</p> <p>1.3. the behavior, personality and state of health of the convict during the execution of the sentence;</p> <p>1.4. the social situation of the convict's family;</p> <p>1.5. the distance, time and method of travel from Correctional Institution to the workplace and vice versa which cannot be longer than three (3) hours including both routes;</p> <p>1.6. the convicted person is not prohibited from exercising the profession or work for which he requests a work permit outside the Correctional Institution;</p>	<p>1. Za izdavanje dozvole za rad van Korektivne institucije moraju se uzeti u obzir sledeće okolnosti:</p> <p>1.1. ispunjenje uslova predviđenih članom 6 ovog uputstva;</p> <p>1.2. pridržavanje plana izricanja kazne i saradnja osuđenog lica u ispunjavanju plana izricanja kazne;</p> <p>1.3. ponašanje, ličnost i zdravstveno stanje osuđenog za vreme izvršenja kazne;</p> <p>1.4. socijalni položaj porodice osuđenog;</p> <p>1.5. udaljenost, vreme i način putovanja od Korektivne institucije do radnog mesta i obrnuto koje ne može biti duže od tri (3) sata uključujući obe pravca;</p> <p>1.6. Osuđenom licu nije zabranjeno da se bavi profesijom ili radom za koji traži radnu dozvolu van Korektivne institucije;</p>

<p>1.7. vendi i punës të jetë i ligjshëm dhe jo i organizuar nga familjarët dhe kolegët e të dënuarit sa për t'i krijuar rrethanat të cilat i mundësojnë të dal jashtë Institucionit Korrektues;</p> <p>1.8. vlerësimi i mundësisë së zbatimit për mbikëqyrjen e kushteve të lejes për punë jashtë Institucionit Korrektues.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Marrëveshja për punën e të dënuarit jashtë Institucionit Korrektues</b></p> <p>1. Pas rekomandimit pozitiv nga Paneli profesional për vlerësim, Drejtori i Institucionit Korrektues lidhë marrëveshje me punëdhënësin dhe të dënuarin për punën jashtë Institucionit Korrektues.</p> <p>2. Marrëveshja e lidhur mes palëve si në paragrafin 1 të këtij neni përmbanë elementet, por pa u kufizuar në:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. orarin e punës, i cili duhet të jetë tetë (8) orë, duke filluar nga ora 08:00 deri ora 16:00;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. vendndodhjen e punës ku do të angazhohet i dënuari;</p>	<p>1.7 the place of work must be legal and not organized by the convict's family members and colleagues to create the circumstances that enable him to leave the Correctional Institution;</p> <p>1.8 assessment of the possibility of implementation for the supervision of the conditions of the work permit outside the Correctional Institution.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>The agreement for the convict's work outside the Correctional Institution</b></p> <p>1. After the positive recommendation from the professional panel, the Director of the Correctional Institution concludes an agreement with the employer and the convict for work outside the Correctional Institution.</p> <p>2. The agreement concluded between the parties as in paragraph 1 of this article contain the following elements but not limited to:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. working hours, which must be eight (8) hours starting from 08:00 to 16:00;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. the location of the work where the convict will be engaged;</p>	<p>1.7. Mesto rada mora biti legalno i ne sme biti organizovano od strane članova porodice i kolega osuđenog za stvaranje okolnosti koje mu omogućavaju da napusti Korektivnu instituciju;</p> <p>1.8 procena mogućnosti sprovođenja nadzora nad uslovima radne dozvole van Korektivne institucije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Ugovor o radu osuđenog van Korektivne Institucije</b></p> <p>1. Nakon pozitivne preporuke od profesionalnog panela za procenu, direktor Korektivne institucije zaključuje ugovor sa poslodavcem i osuđenim za rad van Korektivne institucije.</p> <p>2. Ugovor zaključen između strana iz stava 1. ovog člana elemente bez ograničenja na:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1 radno vreme koje mora biti osam (8) časova počev od 08:00 do 16:00 časova;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. mesto rada na kome će osuđeni biti angažovan;</p>
---	--	---

<p>2.3.transportin;</p> <p>2.4. ushqimin;</p> <p>2.5. mënyrën e kontaktit;</p> <p>2.6. monitorimin nga Institucioni Korrektues;</p> <p>2.7. informacioni lidhur me shkeljet e rregullave nga i dënuari;</p> <p>2.8. ndërprerja kontratës;</p> <p>2.9. kohëzgjatjen e marrëveshjes;</p> <p>2.10.zgjidhja e marrëveshjes.</p> <p>3. Institucioni Korrektues nuk i kompenzon ofruesit të vendit të punës asnjë shpenzim të shkaktuar nga i dënuari i punësuar jashtë Institucionit Korrektues.</p> <p>4. Autoritetet e Institucionit Korrektues nuk janë përgjegjëse për ndonjë dëmtim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të shkaktuar në vendin e punës për shkak të ndërprerjes së papritur të punës jashtë Institucionit Korrektues.</p> <p>5. Institucioni Korrektues nuk mban asnjë përgjegjësi për lëndimet e të dënuarit apo shkaktimin e lëndimeve personave të tjerë gjatë punës jashtë Institucionit Korrektues.</p>	<p>2.3. transportation;</p> <p>2.4. food;</p> <p>2.5. The method of contact;</p> <p>2.6. monitoring by Correctional Institution;</p> <p>2.7. information related to violations of the rules by the convict;</p> <p>2.8. termination of the contract;</p> <p>2.9. the duration of the agreement;</p> <p>2.10. termination of the agreement.</p> <p>3. Correctional Institution does not compensate the workplace provider for any expenses incurred by the convict employed outside the Correctional Institute.</p> <p>4. Correctional Institution authorities are not responsible for any direct or indirect damage caused to the workplace due to sudden termination of work outside Correctional Institute.</p> <p>5. Correctional Institution does not bear any responsibility for the injuries of the convict or causing injuries to other persons while working outside Correctional Institute.</p>	<p>2.3. transport;</p> <p>2.4. hrana;</p> <p>2.5. način kontakta;</p> <p>2.6. praćenje od strane Korektivne institucije;</p> <p>2.7. informacije u vezi sa kršenjem pravila od strane osuđenog;</p> <p>2.8. raskid ugovora;</p> <p>2.9. trajanje ugovora;</p> <p>2.10. resavanje spora.</p> <p>3. Korektivne institucije ne nadoknađuje pružaocu radnog mesta bilo kakve troškove osuđenog zaposlenog van Korektivne institucije.</p> <p>4. Organi Korektivne institucije nisu odgovorni za bilo kakvu direktnu ili indirektnu štetu prouzrokovanu na radnom mestu usled iznenadnog prekida rada van Korektivne institucije.</p> <p>5. Korektivna institucija ne snosi nikakvu odgovornost za povrede osuđenog ili nanošenje povreda drugim licima na radu van Korektivne institucije.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 12 Vendimmarrja</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12 Decision-making</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12 Donosenje odluka</b></p>
